



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA TIRANË**  
**DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE**  
**NJËSIA E PROKURIMIT**

**PROCES – VERBAL Nr.1**

**“Për Hartimin, Argumentimin dhe Miratimin e Kritereve të Veçanta për Kualifikim dhe Specifikimeve Teknike, që lidhen me kapacitetin ekonomik dhe financiar, kapacitetin teknik të procedurës së prokurimit me objekt:**

***“Furnizim- Vendosje raftë arkivore të palevizshme”.***

I mbajtur sot më datë 03.03.2023, në Drejtorinë e Përgjithshme të Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Tiranë nga Njësia e Prokurimit e ngritur me Urdhër Prokurimit me Nr. 5754/10 Prot., datë 03.03.2023, për realizimin e prokurimit me procedurë “Procedurë e Hapur e thjeshtuar” me objekt: ***“Furnizim- Vendosje raftë arkivore të palëvizshme”.***, me **fond limit: 4.630.118 (katër milion e gjashtëqind e tridhjetë mijë e njëqind e tetëmbëdhjetë) lekë pa TVSH**, vënë në dispozicion nga buxheti i Bashkisë Tiranë për vitin 2023, me anë të Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr. VKB Nr. 126 datë 23.12.2022 “Për Miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2023-2025 dhe detajimin e Buxhetit të Bashkisë Tiranë për vitin 2023” si dhe shkresave me Nr.Prot 5754 datë 26.01.2023 të Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse dhe shkresa me Nr.Prot 5754/1 datë 15.02.2023 të Drejtorisë Ekonomike “Dërgim Fondi sipas planit të shpenzimeve kapitale për vitin 2023”

Në zbatim të Nenin 21 pika 1, Neni 2, pika 2 c), Neni 33, Neni 41, pika 1 ë) dhe pika 2, të Ligjit Nr. 162 datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”, Nenin 11, dhe Nenin 78 pika 2 të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, Autoriteti Kontraktor Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore ka hartuar proces verbalin për hartimin, argumentimin dhe miratimin e kritereve të veçanta për kualifikim me përmbajtjen si më poshtë:

**Procedura e këtij prokurimi është: Procedure e Hapur e Thjeshtuar**

**Objekt i prokurimit është: “Furnizim- Vendosje raftë arkivore të palëvizshme”.**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):** Kodi për: Raftë për arkivim 39131100-0

**Numri i referencës së procedurës /Lotit: REF- 61335-03-03-2023**

**Fondi limit i këtij prokurimi është në masën: 4.630.118 (katër milion e gjashtëqind e tridhjetë mijë e njëqind e tetëmbëdhjetë) lekë pa TVSH, vënë në dispozicion nga buxheti i Bashkisë Tiranë për vitin 2023**

**Afati i kryerjes së shërbimit do të jetë:** 5 ditë nga momenti i nënshkrimit të Kontratës.

**Afati kohor për dorëzimin e ofertave:**Nenit 49, pika 3 e Ligjit nr. 162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, ku përcaktohet se “*Afati për pranimin e ofertave në këtë procedurë prokurimi është jo më pak se 10 ditë nga publikimi i njoftimit të kontratës.*”

**Afati kohor për dorëzimin e ofertave është 10 ditë.**

**Kontrata:**

Në nenin 4, pika 18 të Ligjit Nr. 162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”.

“Kontrata publike furnizimi” janë kontratat publike, që kanë objekt blerjen, blerjen me pjesë ose me këste, qiranë me ose pa mundësi blerjeje të mallrave. Një kontratë publike furnizimi mund të përfshijë në mënyrë dytësore edhe vendosjen edhe instalimin.Sa më sipër do të jetë Kontratë Shërbimi.

**Nenkontraktimi:**Nuk lejohet

**Lejohen pagesa të drejtpërdrejta të nënkontraktorit: JO**

Gjuha e prokurimit: **Shqip**

Dokumentet standarde të tenderit: Procedure e Hapur e Thjeshtuar

**MIRATIMIN E DOKUMENTAVE STANDARDE TË TENDERIT PËR MALLRA, PUNË, SHËRBIME PËR PROCEDURËN E PROKURIMIT "PROCEDURË E HAPUR, E THJESHTUAR"**

**KRITERET E PËRGJITHSHME TË PERZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT**

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda

Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;

d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;

dh) Operatori Ekonomik nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;

e) Operatori Ekonomik ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

f) Operatori Ekonomik nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

g) Operatori Ekonomik ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;

gj) Operatori Ekonomik ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

h) Operatori Ekonomik kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.

i) operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

### **Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.**

**Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.**

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

➤ Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

➤ Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e

nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

## **I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

### **1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

#### **a. Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;**

**Argumentimi:**Ky kriter u vendos sipas nenit 29 te VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik“, ne te cilen eshte e parashikuar se: *1. Oferta ekonomike përmban vlerën ekonomike pa TVSH. 2. Operatori ekonomik duhet të hartojë në mënyrë të pavarur, ofertën ekonomike.*

#### **b. Lista e cmimeve te artikujve, sipas Shtojces 2;**

**Argumentimi:**Kjo shtojce eshte pjese e setit te dokumenteve standarte te tenderit per proceduren e prokurimit te sipercituara.

#### **c. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;**

**Argumentimi:** Ky kriter u vendos sipas nenit 83 Ligjin nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, ne te cileneshte e parashikuar se: *Pika 1 Neni 83: Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.Pika 2 Neni 83: Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit:a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përlllogaritur të kontratës;b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës, si dhe ne nenin 30 te VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”*

#### **d.Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8;**

**Argumentimi:**Ky kriter u vendos me mbeshtetje ne nenin 76 të Ligjit nr. 162/2020“Për Prokurimin Publik“, dhe nenin 26 te VKM nr. 285, date 19.05.2021 ”Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”,ne te cilen eshte e percaktuar se: *“1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.”.*

## 2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

### 2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

**2.2.1 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë certifikatën ISO 9001:2015 mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë”, me objekt aktiviteti të certifikates në përputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga nje organ i vleresimit të konformitetit akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizma nderkombetare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Certifikata duhet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.**

**Argumentimi:** Ky kriter i percaktuar ne piken a) është vendosur ne perputhje me piken 1 te nenit 79 te Ligjit nr.162/2020 ”Per Prokurimin Publik”, ne te cilen gjejme te percaktuar se: *1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatatë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.* Ky kriter gjen mbështetje ne piken 1 te nenit 44 te VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik” ku percaktohet se: *1. Autoriteti/entikontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, I plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatatë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.* Gjithashtu ky kriter gjen mbështetje dhe ne rekomandimin e APP dhe Drejtorise se pergjithshme te Akreditimit nr. 3330 prot, date 20.03.2018 dhe nr. 145 prot, date 16.03.2018 “Rekomandim mbi hartimin e kerkesave te cilesise”.

Autoriteti ka vendosur si kriter kualifikues kriterin e mësipërm pasi ky kriter jep sigurinë autoritetit që operatori ekonomik fitues do përmbushë kërkesat për realizimin me sukses të kontratës së shpallur, është kërkuar ISO 9001: 2015 e cila përcakton kriteret për një sistem të menaxhimit të cilësisë dhe mund të përdoret nga çdo organizatë, e madhe apo e vogël, pavarësisht nga fusha e veprimtarisë së saj. Ky standard bazohet në një sërë parimesh të menaxhimit të cilësisë.

### 2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

**a)Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2019, 2020, 2021, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e Vlerës së përlllogaritur të Kontratës që po prokurohet.**

**Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse OE arrijnë vlerën e xhiros minimale, pra 40% e vlerës së fondit limit, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.**

**Argumentimi:** Ky kriter, është vendosur ne perputhje me piken 3 te nenit 77 te Ligjit nr 162/2020 ”Per Prokurimin Publik” i ndryshuar, ne te cilin gjejme te percaktuar se: *3. Në*

*lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. **Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar.** Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalohet dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.; ne piken 1 dhe piken 2/c të nenit 43 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku përcaktohet se: **Pika 1. Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare.** Pika 2/c: 2. **Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalohet: c) 40 % të vlerës së përlogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar...”. Vendosja e këtij kriteri behet me qëllim krijimin e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të OE ofertues, duke vërtetuar nepermjet dokumenteve të kerkuara me poshte, se zoterojne kapacitet ekonomike dhe financiare për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga AK.***

### **Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:**

Legjislatori në nenin 55/4 të VKM 285/2021 ka parashikuar marzhin maksimal për vlerën e xhiros, që mund të kërkohet në Procedurën e Hapur të Thjeshtuar, e cila është 40 % e vlerës së përlogaritur të kontratës. Për të provuar aftësinë /përshtatshmërinë profesionale të OE, AK duke analizuar rast pas rasti bazuar në parimin e proporcionalitetit në objektin e kontratës që do të prokurohet, ka gjuar te arsyeshme përcaktimin e kësaj vlere për të krijuar besueshmërinë e nevojshme në kapacitetet profesionale të OE. Në këtë mënyrë AK krjon bindjen e përgjithshme në aftësinë profesionale të OE duke u bazuar në përvojat e mëparshme të tij realizuar në sektorin privat/publik për të marrë përsipër realizimin dhe zbatimin e objektit të kontratës që do të prokurohet

**2.2.2** Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve: (2019, 2020, 2021) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me *raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushur nese ne dy bilance te njepasnjeshme nuk ka raporte negative ndermjet aktivitetit dhe pasivitetit.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Kapaciteti pozitiv financiar i operatorit i dokumentuar me bilance i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës. Pasqyrat financiare me bilanc pozitiv paraqesin vërtetësi dhe besueshmëri në pozicionin financiar të operatorit ekonomik.



## 2.3 Kapaciteti teknik:

**2.3.1** Dëshmi nga operatori ekonomik për furnizime të mëparshme të ngjashme në një vlerë **jo më të vogël se 20% e vlerës së fondit limit** dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

- Si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkohen vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

**Argumentimi:** Ky kriter u vendos në përputhje me piken 4 të nenit 77 të Ligjit nr. 162/2020, "Per Prokurimin Publik", në të cilin gjejmë të percaktuar se: *4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës; si dhe me piken 4 të nenit 40 të VKM nr 285 date 19.05.2021 "Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", në të cilën është e percaktuar se: [...]. 4. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.*

Vendosja e këtij kriteri behet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë teknike të OE ofertues, nëpërmjet përvojave të duhura, që janë në përputhje me natyrën e objektit të prokurimit dhe që ka aftësinë e duhur për zbatimin e kontratës sic është parashikuar nga AK.

**2.3.2** Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar në stafin e tij të paktën **5 (pesë)** punonjës për montimin e rafteve pranë ambjenteve të A.K. .

Për të vërtetuar këtë pikë, operatori ekonomik duhet të paraqese: kontratat individuale të punës të vlefshme në kohën e zhvillimit të procedurës ose/dhe listëpagesat e deklaruara të punonjësve, sipas formatit E-Sig 025/a, për periudhën **Nëntor 2022 - Janar 2023**, të konfirmuara nga administrata tatimore. Ndër to duhet të ketë të punësuar të paktën:

- a) 1 (një) inxhinier mekanik, vërtetuar me:
  - Kontratë pune e vlefshme;
  - Diplomë;
  - Listpagesat sipas formularit E-Sig 025/a për 3 muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, sipas legjislacionit në fuqi.
- b) 1 (një) punonjës të trajnuar (certifikatë) për antisizmicitetin, vërtetuar me:
  - Dëshminë (certifikatë) trajnimi nga kompania;
  - Listpagesat sipas formularit E-Sig 025/a për 3 muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, sipas legjislacionit në fuqi.
- c) 1 (një) punonjës të trajnuar (certifikatë) për anën teknike baze të montimit të rafteve, vërtetuar me:
  - Dëshminë (certifikatë) trajnimi nga kompania prodhuese;
  - Listpagesat sipas formularit E-Sig 025/a për 3 muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, sipas legjislacionit në fuqi.

**Shënim:** Ky kriter në fazën e ofertimit të operatorëve ekonomik do të konsiderohet i përmbushur me dorëzimin/paraqitjen e formularit përmbledhës të vetdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Në rastet kur OE kualifikohet i pari duhet të paraqesë dokumentacionin provues sipas këtij kriteri, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

**Argumentimi:** Ky kriter u vendos në përputhje me piken 4 të nenit 77 të Ligjit nr. 162/2020, "Per Prokurimin Publik", në të cilin gjejmë të percaktuar se: *4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës; si dhe me piken 41, pika 4/ b) dhe c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" ku percaktohet: "4. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:*

- a) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose



b) *fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose ...”*

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm për realizimin me sukses të kontratës. Ky numer minimal është kërkuar duke u bazuar ne nevojen per kryerjen e furnizim vendosjes brenda afateve te percaktuara ne keto DST. Vendosja e ketij kriteri behet me qellim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, per aftesine teknike te OE ofertues, nepermjet burimeve e nevojshme njerëzore, qe jane ne perpjesetim me natyren e objektit te prokurimit dhe qe ka aftesine e duhur per zbatimin e kontrates sic eshte parashikuar nga AK.

a) Operatori ekonomik duhet të dorëzojë një deklaratë në të cilën të deklarojë se mallrat objekt i procedurës do të montohen prej tij në ambientin e caktuar nga AK, sipas specifikimeve të përcaktuara në këto DST brenda afatit të lëvrimit.

**Argumentimi:** Ky kriter u vendos në përputhje me piken 4 te nenit 77 te Ligjit nr. 162/2020, "Per Prokurimin Publik", si dhe ne piken 4 te nenit 41 te VKM nr 285 date 19.05.2021 "Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik". Vendosja e ketij kriteri behet me qellim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, per zbatimin e kontrates sic eshte parashikuar nga AK. Autodeklarata nga ofertuesi, eshte një dokument i domosdoshëm për t'u paraqitur, në mënyrë që autoriteti kontraktor të sigurohet që subjekti/shoqëria që do te kryeje dhe vendosjen e mallit ne ambientin e percaktuar..

b) Operatori ekonomik duhet të paraqesë autodeklaratë se artikujt e kërkuar janë prodhim sipas standarteve (CE).

**Argumentimi:** Ky kriter i percaktuar ne piken b) eshte vendosur ne perputhje me piken 1 te nenit 79 te Ligjit nr.162/2020 "Per Prokurimin Publik", ne te cilen gjejme te percaktuar se: *1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatatë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve tëkandidatit ose të ofertuesit.* Ky kriter gjen mbeshtetje ne piken 1 te nenit 44 te VKM nr 285 date 19.05.2021 "Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik" ku percaktohet se: *1. Autoriteti/entikontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, I plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatatë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.* Gjithashtu ky kriter gjen mbeshtetje dhe ne rekomandimin e APP dhe Drejtorise se pergjithshme te Akreditimit nr. 3330 prot, date 20.03.2018 dhe nr. 145 prot, date 16.03.2018 "Rekomandim mbi hartimin e kerkesave te cilesise". Autodeklarata nga ofertuesi, eshte një dokument i domosdoshëm për t'u paraqitur, vendosja e ketij kriteri behet me qellim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, per zbatimin e kontrates sic eshte parashikuar nga AK.

## **II. Argumentimi i Specifikimeve Teknike**

### **Shtojca 5.**

#### **1. Qëllimi :**

Autoriteti Kontraktor Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore, në zbatim të Ligjit Nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”, me qëllim përmbushjen e standardeve arkivore konform të gjithë legjislacionit në fuqi, kërkon të realizoj blerjen dhe montimin/vendosjen e rafteve metalik me qëllim arkivimin e të gjithë dokumentacionit ligjërish të detyrueshëm për t’u arkivuar.

#### **2. Objekti :**

Objekti i kësaj procedure konsiston në blerjen, montimin/vendosjen dhe kolaudimin e rafteve metalik prej çeliku special dhe të palëvizshëm sipas përcaktimeve dhe nevojave të sektorit të Arkivës dhe Protokollit të A.K. . Këto rafte duhet të sigurojnë kushte arkivimi optimale, si: peshëmbajtje të lartë, rezistent ndaj ndryshkjes, të qëndrueshëm gjatë luhatjeve të ndryshme sizmike, të regjistrueshëm në lartësi sipas nevojave, lehtësisht të zmontueshëm, etj. Raftet duhet të realizohen sipas përmasave të kërkuara dhe të kenë vrima të hapura në të gjithë lartësinë e strukturës së këmbëve në mënyrë që të krijojnë mundësinë të lidhen njëri me tjetrin me vida dhe bulona.

#### **3. Detyrat :**

Operatori ekonomik i shpallur fitues, brenda vlerës së ofertuar, duhet të siguroj me mundësitë dhe shpenzimet e veta transportin dhe montimin e rafteve në ambjentet e Autoritetit Kontraktor. Përpara fillimit të prodhimit të rafteve duhet të merren përmasat (të kryhet matja) e ambjenteve dhe të realizohen matjet faktike për dimensionet e rafteve me qëllim shmangien e gabimeve në prodhim dhe në vendosje. Montimi i pjesëve të raftit dhe bashkimi i rafteve me njëri-tjetrin të realizohet me dado dhe bulona, në mënyrë të tillë që rafti të mos pësoj lëkundje apo palosje.

#### **4. Vendi i vendosjes/montimit të mallrave objekt prokurimi :**

Në ambjentet e brendshme të Drejtorisë së Përgjithshme të Taksave dhe Tarifave Vendore, me adresë: Rruga Shefqet Musaraj, pranë kompleksit rezidencial “Square 21”, 1023, Tiranë - Shqipëri. Përpara fillimit të prodhimit dhe të montimit të rafteve duhet të merren dimensionet e ambjentit/ambjenteve me qëllim shmangien e gabimeve në ndërtim dhe vendosje.

#### **5. Specifikimet teknike :**

Specifikimet teknike për raftet metalik të kërkuara janë si mëposhtë vijon:

- Të jenë të përbër prej çeliku special S400 të zinkuar me procesin “Sendzimir”;

- Të jenë të regjistrueshëm në lartësi, çdo 3 cm për secilin sergjen (ndarje);
- Të jenë praktikisht të pa korrodueshëm ndaj agjentëve të jashtëm atmosferik;
- Të jenë lehtësisht të zmontueshëm dhe estetik;
- Të jenë të qëndrueshëm, në mënyrë që të mund t'u rezistojnë luhatjeve të ndryshme sizmike;
- Të jenë rezistent ndaj zjarrit dhe lagështirës;
- Të jenë prodhim sipas standarteve CE (Komuniteti Europian);
- Të jenë të hapur si në pjesën ballore ashtu dhe në pjesën e pasme, me qëllim ajrosjen e materialeve arkivore;
- Raftet duhet të montohen dhe qëndrojnë në vetevete pa patur nevojë për struktura mbështetëse.
- Peshëmbajtja minimale për çdo ndarje (sergjen): jo më pak se 100 (njëqind) kg me ngarkesë uniformisht të shpërndarë;
- Lartësia e sergjenit (raftit) të parë nga dyshemeja duhet të jetë nga 20 deri në 30 cm, bazuar kjo në ligjin Nr. 9154, Datë 06.11.2003 "Për Arkivat", Neni 105.

## 6. Afatet e ekzekutimit :

Afati i furnizimit dhe vendosjes/montimit të rafteve do të jetë: brenda 5 ditë pune nga momenti i nënshkrimit të kontratës e deri në montimin/vendosjen e plotë të të gjitha rafteve të kërkuara.

## 7. Fondi limit :

Bazuar në VKB Nr. 126, datë 23.12.2022 për "Miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2023-2025 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë Tiranë për vitin 2023", si dhe Shkresës Nr. 1235/3 prot., datë 02.02.2023 të Bashkisë Tiranë, mbi Njoftimin e planit të shpenzimeve operative për vitin 2023, është akorduar fondi prej **5.875.855** (pesëmilion e tetëqind e shtatëdhjetë e pesëmijë e tetëqind e pesëdhjetë e pesë) lekë pa t.v.sh., nga ana e Bashkisë Tiranë, për zërin "**Blerje raftet metalike arkivimi**".

Referuar Ligjit Nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", si dhe Kreut X, Neni 76, i VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për Rregullat e Prokurimit Publik", me ndryshime, ku shprehimisht përcaktohet se: "*Në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti/enti kontraktor duhet t'i referohet një ose më shumë alternativave të renditura, si më poshtë vijon:*

- a) *çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj.); ose/dhe*
- b) *studimit të tregut, bazuar në mesataren e çmimeve të marra nga ky studim; ose/dhe*
- c) *çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore; ose/dhe*
- ç) *çmimet ndërkombëtare të shpallura publikisht.*

*Autoriteti/enti kontraktor mund t'i referohet një ose më shumë alternativave të mësipërme në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, me qëllim që ajo të jetë një vlerë reale për kushtet e tregut dhe njëkohësisht të krijojë mundësinë e pjesëmarrjes së sa më shumë operatorëve ekonomikë.*

Për sa më sipër, për përlogaritjen e vlerës së fondit limit të kontratës për furnizimin dhe vendosjen e rafteve arkivore të palëvizshëm, Komisioni ju referua studimit të tregut, bazuar në mesataren e çmimeve sipas ofertave të ardhura nga tre operatorë ekonomik të cilët kanë si objekt tregtimin dhe montimin e mallrave të kërkuara nga ana e A.K. .

## FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT

Nr.	Përshkrimi	Sasia	Njësia
1.	F.V. Raft Arkivor Statik (L) 2000 x (Gj) 1500 x (Th) 800 mm + 5 ndarje (sergjene)	18	copë
2.	F.V. Raft Arkivor Statik (L) 2000 x (Gj) 1500 x (Th) 400 mm + 5 ndarje (sergjene)	6	copë
3.	F.V. Raft Arkivor Statik (L) 2500 x (Gj) 1500 x (Th) 800 mm + 6 ndarje (sergjene)	60	copë
4.	F.V. Raft Arkivor Statik (L) 2500 x (Gj) 1200 x (Th) 800 mm + 6 ndarje (sergjene)	9	copë
5.	F.V. Raft Arkivor Statik (L) 2500 x (Gj) 900 x (Th) 800 mm + 6 ndarje (sergjene)	8	copë
6.	F.V. Raft Arkivor Statik (L) 2500 x (Gj) 1500 x (Th) 400 mm + 6 ndarje (sergjene)	34	copë
7.	F.V. Raft Arkivor Statik (L) 2500 x (Gj) 1200 x (Th) 400 mm + 6 ndarje (sergjene)	7	copë
8.	F.V. Raft Arkivor Statik (L) 2500 x (Gj) 900 x (Th) 400 mm + 6 ndarje (sergjene)	6	copë

### **Afatet e lëvrimit:**

Afati i ndërtimit dhe vendosjes së rafteve të jetë maksimumi 5 ditë kalendarike nga nënshkrimi i kontratës.

**Argumentimi:** Sasia dhe Grafiku i levrimit janë vendosur referuar shkresës nr.5754/9 prot.,date 02.03.2022 “Relacion mbi hartimin e specifikimeve teknike dhe përlogaritjen e e fondit limit per proceduren e prokurimit me objekt : *Furnizim- Vendosje raftve arkivore të palëvizshme*”.

, si dhe ne përputhje me piken 3, germa b te nenit 15 te VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, te ndryshuar.